

RIMËKËMBJE, GJITHPËRFSHIRJE, QËNDRUESHMËRI

Buletini nr. 09 —————>

PRILL 2022



RINGJALLJE

INVESTIM

MBËSHTETJE

QËNDRUESHMËRI

KOORDINIM

PUNËSIM

MIRËQENIE

BARAZI

JETËSIM

EKONOMI

Përfshirja e qytetarëve në procese politkbërëse →

Për buletin

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) në mënyrë periodike bënë publikimin e buletinëve informues mbi procesin e zbatimit dhe monitorimit të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Duke bërë informimin mbi Pakon e Ringjalljes dhe monitorimin e kësaj pako, INDEP synon rritjen e nivelit të transparencës dhe llogaridhënies nga ana e institucioneve të Kosovës ndaj qytetarëve të saj. Buletini “Rimëkëmbje, Gjithpërfshirje, Qëndrueshmëri” është i realizuar në kuadër të projektit “Rimëkëmbje për Qëndrueshmëri” mbështetur nga Balkan Trust for Democracy (BTD) dhe USAID.

Edicioni i nëntë i buletinit në fjalë do të ndalet te përdorimi i platformave digjitale në procese politkbërëse duke u fokusuar kryesisht në atë të konsultimit elektronik, platformën e konsultimeve publike. Meqenëse përfshirja e

qytetarëve në këto procese është jetike për demokraci të mirëfilltë, është e rrugës që qytetarët të informohen mbi të drejtat dhe mundësitë që kanë aktualisht për pjesëmarrje në procese politkbërëse në Republikën e Kosovës. Kjo ka peshë tjetër në kohë të tilla krizash, kohë ku qytetarët përjetojnë kriza ekonomike dhe sociale, dhe patjetër kanë nevojë për adresë të saktë për t'u përfshirë në procese të tilla, të cilët më pas reflektojnë në vendime që i prekin qytetarët cdo ditë. Buletini ofron informacione mbi modelin e qeverisjes të drejtuar nga qytetarët si dhe trajton mundësitë aktuale dhe ndikimin e kontributit të të gjithë palëve të treta si qytetarët, grupet e ndryshme të interesit në procese politkbërëse, dhe tenton të pasqyrojë pak a shumë gjendjen në përgjithësi të Kosovës sa i përket tranzicionit në qeverisjen elektronike.

PËRFSHIRJA E QYTETARËVE NË PROCESHE POLITKBËRËSE DHE VENDIM-MARRËSE

Përparimi i e-qeverisjes varet nga faktorë të ndryshëm si teknologjia e informacionit, vullneti legjislativ, infrastruktura, menaxhimi i burimeve njerëzore dhe besimi i publikut. E-qeverisja promovon pjesëmarrjen e qytetarëve në administratën publike përmes kontribuimit me komente apo rekomandime në lidhje me projekte, propozime, strategji, nisma të ndryshme, si dhe rrit transparencën dhe llogaridhënien, si dhe rrit efikasitetin dhe efektivitetin e grupeve shoqërore si OShC-të, për shkak të mundësisë dhe sfidave që iu ofrohen në vazhdimësi në e-qeverisje. Në mënyrë që të zhvillohet qeverisja elektronike qeveritë punojnë në drejtime të shumta, fillimisht duke përmirësuar apo hartuar legjislacionin e nevojshëm, më pastaj duke krijuar infrastrukturën dhe në fund duke vendosur në praktikë, gjithmonë duke zbatuar Ligjin në fuqi. Megjithatë duhet të theksohen dhe të analizohen dy aspektet e rëndësishme të e-qeverisjes, fuqia e e-qeverisjes për të forcuar demokracinë duke rikthyer sferën publike tek qytetarët, si dhe roli i qeverisë në adresimin e përdorimit dhe qasjes jo të njëjtë dhe të pabarabartë për të gjithë në TI.

Padyshim që pjesëmarrja aktive e qytetarëve përmes e-qeverisjes në procese politikbërëse dhe vendimmarrëse luan rol gjithnjë e më të rëndësishëm në bashkëkrijimin e vlerave për çështjet e përbashkëta publike. E-qeverisja premton përmirësim të dukshëm për përmirësimin e proceseve qeveritare në përgjithësi përmes bashkëprodhimit qytetar. Një shoqëri ideale mund të konsiderohet ajo shoqëri që qeveriset në mënyrë digjitale, në të cilën padiskutim ka pak për të mos thënë fare hapsirë për keqpërdorim dhe korrupsion.

Mbi 90% e popullsisë në Kosovë kanë qasje në internet

Megjithatë, duhet të përmendet se globalisht, ende lë për të dëshiruar qasje e popullsisë në internet, i cili është kusht fillestar për të pasur mundësi shfrytëzimin e shërbimeve elektronike qeverisëse, për këtë arsye edhe pse interneti është platforma më e fuqishme për të aplikuar e-qeverisjen, nuk është hapësira më e përshtatshme për të gjithë popujt, komunitetet, grupet e ndryshme shoqërore. Por përkundër kësaj, aplikimi i e-qeverisjes në internet për përdoruesit aktual do të ishte mekanizëm i duhur për të ju krijuar hapësirë palëve të ndryshme që të shprehim mendim, dhe të debatojnë në kushte të barabarta. Përveç që nevojitet një pjesëmarrje e dendur e gjerë e qytetarëve për e-qeverisje, nevojiten edhe pjesëmarrës cilësor të cilët do të duhej të informoheshin në vazhdimësi mbi proceset politike në mënyrë që të mund të kontribuonin efektshëm në sferën publike dhe të ndërtohet nga të gjithë një e ardhme me kushte dhe të drejta të barabarta.¹

¹ Manoharan, AM, Holzer, MH. (2011). 'E-governance and Civic Engagement: Factors and Determinants of E-democracy'. Qasur për herë të fundit më 31.01.2022.



PLATFORMA E KONSULTIMEVE PUBLIKE →

Qeverisja elektronike apo e-qeverisja është aplikimi i teknologjisë së informacionit në funksionet dhe procedurat e qeverisë, në mënyrë që qeverisja të jetë sa më eficiente, efikase e transparente, duke përmirësuar kështu edhe jetën e qytetarit, si dhe duke përfshirë atë dhe të gjithë hisedarët relevantë në proceset politik-bërëse. Teknologjia informative ka ndryshuar mënyrën klasike e të bërit politika, duke bërë jashtëzakonisht më të lehtë pjesëmarrjen dhe aktivizimin e qytetarëve për vendimet që në fund të fundit i prekin direkt ata. Duke qenë se mënyra tradicionale e të qeverisurit ka ndryshuar, rrjedhimisht janë ndryshuar edhe proceset politik-bërëse dhe mënyrat e të ofruarit të shërbimeve tek qytetarët, duke krijuar kështu nevojën për platforma të ndryshme digjitale të cilat janë lehtë të qasshme nga çdo kush dhe në çdo kohë. Me aplikimin e teknologjisë informative në procese të tilla, është rritur efikasiteti, transparenca, llogaridhënia, pjesëmarrja e qytetarisë aktive, si dhe është ulur korrupsioni.




Duke pasur parasysh qasjen e madhe të popullsisë në internet në Republikën e Kosovës, mundësitë janë më të lehta për digjitalizim të shpejtë dhe të suksesshëm të administratës publike, faktor shpresëdhënës ky që do të duhej të motivonte qeveritë qendrore dhe lokale për të reaguar më shpejtë në këtë drejtim. Një nga iniciativat më të rëndësishme të marra nga Qeveria e Kosovës është përpilimi i Rregullores 05/2016 për Standardet Minimale të Konsultimit Publik nga ZKM e cila ka rezultuar me krijimin e platformës për konsultim publik. Platforma për Konsultim Publik ka për qëllim të ndihmojë ministrinë dhe agjencitë e Qeverisë së Kosovës, e të komunikojnë me palët e treta dhe të përfshijnë akterat relevantë në proceset politikbërëse dhe ato vendimmarrëse të nivelit lokal dhe qendror. Përvec tjerash, funksionimi i një platforme të tillë mundëson edhe rritjen e transparencës dhe përgjegjësisë nga institucionet qeveritare. Andaj, promovimi i platformës, dhe zbatueshmëria e plotë e Rregullores 05/2016, duhet të jenë prioritet i qeverive të cilat synojnë kah një e ardhme digjitale.

Republika e Kosovës ka aprovuar në vitin 2016 Rregulloren për Standarde Minimale për procesin e konsultimit publik. Kjo rregullore obligon ZQM-në që operon në kuadër të ZKM-së të krijojë dhe mirëmbajë platformën online të konsultimit publik.

Republika e Kosovës ka aprovuar në vitin 2016 Rregulloren për Standarde Minimale për procesin e konsultimit publik.

Rregullorja obligon të gjitha ministrinë Platforma mund të shfrytëzohet nga të gjitha organet publike për të zhvilluar konsultimin me publikun dhe për të identifikuar hisedarët në një proces të caktuar politik-bërës. Sipas Rregullores për Standarde Minimale, platforma elektronike e konsultimit publik ofron mundësinë që të gjithë hisedarët duke përfshirë këtu organet publike, palët e interesuara dhe publikun, të përfshihen dhe të japin kontributin e tyre në procese të ndryshme politik-bërëse, duke bërë kështu hapa konkret drejtë formimit të së ardhmes së tyre.




INPUTET E QYTETARËVE DHE INFORMATAT KTHYSE



Angazhimi dhe pjesëmarrja përmes platformave digjitale të palëve të treta, që përfshijnë qytetarët, shoqërinë civile, mediat, entitetet ekonomike, grupe të ndryshme interesi është element fundamental i një qeverie transparente dhe llogaridhënëse. Përveç tjerash, kjo mundëson edhe realizimin e suksesshëm të modelit të qeverisjes të drejtuar nga vet qytetarët, ku zgjidhjet e problemeve dhe projekt-propozimet vijnë nga një sërë akterësh që kanë interesa të veçantë dhe të ndryshëm dhe janë plotësisht të pavarur. Kjo qasje i krijon mundësitë edhe qeverive të identifikojnë zgjidhje dhe ide të reja edhe duke pasur në dispozicion burime të ndryshme, kështu duke shpenzuar më pak, gjithmonë duke u nisur nga parimi 'doing more with less'.

Kontributi i palëve të treta në procese politik-bërëse është tepër i rëndësishëm, por jo çdoherë i lehtë për t'u bërë. Sfidë e qeverisë për aplikimin e teknologjisë së informacionit në qeverisje, sidomos në angazhimin e qytetarëve përmes platformave digjitale, konsiderohet edhe e ashtuquajtura ndarje digjitale. Ky fenomen i sjell qeverisë, barrën e krijimit të infrastrukturës dhe qasjes të të gjithëve në internet, e duke qenë ende vend në tranzicion, qytetarët e Republikës së Kosovës, përballen në përditshmëri me probleme ekonomike, sociale e të tjera. Megjithatë problemin e qasjes në internet, Kosova duket ta ketë dukshëm më të vogël, duke qenë e evidentuar se mbi 90% e popullsisë kanë qasje në internet.² Megjithatë, qeveria mban barrën e të siguruarit të mundësive teknologjike edhe për pjesën që nuk përfitojnë nga ky shërbim.



² Open Data Kosovo 'Kosova Observatori i Agjendës Digjitale'. (2020). Qasur për herë të fundit më 30.01.2022.

Përkundër kësaj, në Kosovë është e evidentuar se qytetarë si individë nuk japin kontributin e tyre në doza të mjaftueshme përmes platformave digjitale. Qytetarët, në raste shumë të rralla përdorin Platformën e Konsultimeve Publike për të dhëne mendime dhe rekomandime mbi iniciativat e ndërmarra nga institucionet qeveritare. Megjithatë, e njëjta nuk mund të thuhet për shoqërinë civile, meqenëse OShC-të dhe grupe të ndryshme të interesit janë aktive dhe kontribuojnë me komente dhe rekomandime në vazhdimësi. Në përgjithësi, edhe pse ka pasur përparime në aspektin e hartimit të legjislacionit dhe përafrimit të tij me legjislacionin evropian dhe krijimit të platformës digjitale për konsultim publik në nivel qendror, agjenda digjitale dhe e-qeverisja nuk janë priorizuar në mënyrën e duhur në agjendat qeveritare, dhe për këtë arsye ngelemi ende prapa në këtë drejtim. Nevojitet një ndërgjegjësim i qytetarëve për rolin dhe të drejtat që kanë për t'u përfshirë në procese politik-bërëse dhe ato vendimmarrëse, nevojitet hartim i legjislacionit të ri në këtë drejtim si dhe vënia në praktikë dhe implementimi i rregulloreve të cilat vec janë në fuqi. E gjithë kjo, në mënyrë që të bëhet progres dhe të avancohet agjenda digjitale në Kosovë.



REKOMANDIME



- Duke pasur parasysh se në kohën moderne pjesëmarrja e publikut në procese politikkbërëse dhe vendimmarrëse është kriter i parë dhe thelbësor për një qeverisje të mirë, transparente dhe llogaridhënëse, konsiderohet i nevojshëm krijimi i kushteve nga pushteti legjislativ dhe ai ekzekutiv për të jetësuar modelin e qeverisjes nga vet qytetarët. Krijimi i kushteve legjislative është vetëm hapi i parë i cili duhet ndërmarrë sa më e shpejtë që është e mundur nga çdo qeveri e cila pretendon dhe ka ambicie të drejtojë qeverisjen drejtë digjitalizimit. Orientimi i proceseve të punës drejtë e-qeverisjes duhet të bëhet në cdo strukturë organizative të administratës publike. Hap tjetër është krijimi i infrastrukturës në aspektin teknik që përfshin procesin e adaptimit të mjeteve dhe shërbimeve teknologjike, që rrjedhimisht konkludon në lehtësimin e jetës së qytetarit dhe përfshirjen e tij në të gjitha proceset politikkbërëse dhe vendimmarrëse. Padyshim që për të krijuar një ambient digjital të punës duhen plotësuar edhe kushte tjera, megjithatë vullneti politik në këtë pikë është primar.
- *Promovimi i pjesëmarrjes së qytetarëve në procese politikkbërëse dhe vendimmarrëse përmes platformave digjitale*, është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Kjo duke pasur parasysh faktin fillimisht se jo të gjithë qytetarët, grupet e interesit apo entitete të caktuara janë të ndërgjegjshëm për të drejtat që kanë si akterë relevantë në procese të caktuara. Vetëdijësimi i ulët bën që qytetarët të mos jenë të ndërgjegjshëm për rolin e rëndësishëm që kanë në procese politikkbërëse dhe vendimmarrëse, duke qenë se qeverisja tradicionale sidomos ajo e aplikuar në Kosovë, ka përfshirë pak, për të mos thënë fare publikun në procese të tilla të rëndësishme. Ndërgjegjësimi i popullit fillimisht për të drejtat që posedojnë dhe pastaj mënyrën si mund të bëhen pjesë e këtyre proceseve, në rastin në fjalë duke përdorur mjete të ndryshme të teknologjisë informative si platformat digjitale do të ishte hap i rëndësishëm i marrë duke i paraprirë proceseve të tjera si infrastruktura ligjore dhe teknike në aspektin e e-qeverisjes. Tashmë agjenda digjitale është bërë prioritet i të gjitha vendeve dhe krijimi i kushteve për zbatimin e e-qeverisjes është i domosdoshëm duke qenë se duhet aplikuar modele të qeverisjes të drejtuara nga qytetarët dhe nga të dhënat, dhe pa krijuar infrastrukturën e nevojshme këto dhe elemente të tjera që shpiejnë drejtë tranzicionit digjital nuk do të mund të arrihen. Patjetër që për të bërë këtë duhet përfshirë edhe akterë të tjerë si shoqëria civile dhe grupe të tjera të cilët janë të përfshirë në ofrimin dhe përdorimin e platformave dhe shërbimeve digjitale.
- *Zbatimi i plotë i rregullores 05/2016*, që është tashmë në fuqi prej vitit 2016, i ka paraprirë krijimit të platformës digjitale për konsultime publike. Platforma është tashmë funksionale, por jo çdoherë përdoret për arsyen që është krijuar. Organet si ministrë dhe agjencitë e Qeverisë, të cilat janë të obliguara me ligj të publikojnë cdo nismë legjislative apo projekt propozim në platformë për konsultim publik jo çdoherë bëjnë këtë edhe pse rregullorja obligon të kundërtën. Tashmë 7 vjet nga hyrja në fuqi e rregullores, por ende ka raste të cilat evidentohen me një kërkim në platformë, ku ministri dhe agjenci të caktuara nuk kanë bërë konsultimin paraprak publik me qytetarin. Nevojitet një zbatim i plotë i rregullores nga të gjitha institucionet që janë nën ombrellën e saj, të cilat duhet të publikojnë cdo nismë legjislative dhe të zbatojnë në plotëni rregullat pas publikimit, të cilat janë kthimi i përgjigjes në afate të caktuara, e publikimi i vendimit final.





B | T | D The Balkan Trust
for Democracy
A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

“Ky projekt mbështetet nga Balkan Trust for Democracy (BTD) një projekt i Fondit Gjerman Marshall të SHBA-ve dhe popullit amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe zbatohet nga Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP. Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet apo opinionet e BTD, GMF, USAID ose Qeverisë së SHBA-së.”